

VENDIM
Nr. 425, datë 26.6.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION DHE ASFALTIM I RRUGËS MARQINET-1 DHE LAGJJA “LLANAJ””, NË BASHKINË E VORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstrukcion dhe asfaltim i rrugës Marqinet-1 dhe Lagjja “Llanaj””, në Bashkinë e Vorës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “tokë bujqësore”, me sipërfaqe 719.2 m², me vlerë të përgjithshme prej 322 201 (treqind e njëzet e dy mijë e dyqind e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 322 201 (treqind e njëzet e dy mijë e dyqind e një) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Vorë, planifikuar në buxhetin e saj me vendim të këshillit bashkiak.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë dhe të përfundojë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi pasi të kenë paraqitur pranë Bashkisë Vorë certifikatën e pronësisë, hartën treguese të regjistrimit si dhe kartelën e pasurisë.

8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Vorë të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vorë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Vorë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit:
“Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Marqinet-1 dhe Lagjja Llanaj”
Bashkia Vorë

Nr.	Emri, Mbiemri (Pronari që shpronësohet)	Zona Kadastr ale	Lloji i pasurisë	Numri kadas tral	Sipërfaqja që shpronësohet /m ²	Çmimi i tokës bujqësore/ lekë/m ²	Vlera e përgjithshme e shpronësimit	Shënime
1	Rexhep Islam Ismaili	2605	"tokë bujqësore"	310/15	465	448	208320	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Fadil Ymer Ismaili	2605	"tokë bujqësore"	308/6	73.2	448	32793	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Ismail Ramazan Ismaili	2605	"tokë bujqësore"	311/45	181	448	81088	Konfirmuar nga ZVRPP
	Shuma				719.2		322 201	